

Ka lindur më 20 Janar të vitit 1959 në Sarandë dhe është diplomuar në vitin 1983 në Fakultetin e Ekonomisë Agrare, duke vijuar studimet e mëtejshme pasuniversitare gjatë viteve 2006-2010 në Universitetin Ndërkombëtar të Strugës në Fakultetin e Shkencave Ekonomike me titullin “Magjistër i Shkencave Ekonomike”. Gjithashtu Z.Çipa ka ndjekur kurse të ndryshme kualifikimi brenda dhe jashtë vendit në fushën e politikës, ekonomisë dhe sigurisë kombëtare. Z.Çipa ka një karrierë të pasur politike. Karriera e Stefan Çipës do të niste si Kryetar i Komitetit Ekzekutiv Pluralist Sarandë për vitet 1991-1992, dhe do të kulmonte në vitin 2002 kur Z.Çipa u emërua Ministër i Rendit Publik, duke u rikthyer sërish në këtë ministri në vitin 2016 në pozicionin e Zëvendës Ministrit të Brendshëm. Z.Çipa është mandatuar si Kryetar i Bashkisë Sarandë për harkun kohor 2011-2015.

Z.Çipa ka një karrierë të pasur politike, ku për tre legjislatuara është zgjedhur si deputet i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Në veprimtarinë e tij politike përfshihet ndër të tjera edhe pozicioni i Zv.Kryetarit të Komisioni Hetimor Parlamentar “Mbi përgjimet e paligjshme të Telefonave” -Nënkryetar në vitin 2003 dhe Zv.Kryetar i Komisionit Parlamentar për Sigurinë Kombëtare përgjatë viteve 2006-2008.

Me një eksperiencë pune 25-vjeçare Z.Çipa së fundmi ka mbajtur pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve. Z.Çipa zotëron mirë gjuhën angleze dhe greke.